



Kleona Elezaj, MSc

Lektore
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Tirana Business University College

Kleona Elezaj, MSc., ka një formim të gjerë akademik në fushën e teknologjisë dhe drejtësisë. Ajo ka përfunduar studimet Bachelor në Informatikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, dhe Master në Informatikë Biznesi, Teknologji Informacioni dhe Inovacion. Aktualisht ndjek Masterin Shkencor në të Drejtën Penale në Fakultetin e Drejtësisë, UT.

Pas përfundimit të studimeve, ka ndjekur një karrierë të suksesshme në sistemin bankar dhe mbi dhjetë vite përvojë në arsimin profesional në drejtimin Inxhinieri Informatike - Software, ku ka ushtruar funksione si Përgjegjëse e Departamentit TIK, Koordinator e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Profesional, si dhe Administratore Sistemi.

Prej vitit 2020, ajo është lektore e jashtme në disa universitete publike e jopublike, me ekspertizë në Administrimin e Bazave të të Dhënave, Inteligjencën Artificiale, Programimin në Web dhe Java, si dhe Hartimin dhe Menaxhimin e Projekteve. Znj. Elezaj është e certifikuar nga Intel dhe AADF si Coach për programin “AI for Youth”, si dhe trajnuese e certifikuar nga Cisco Networking Academy. Ajo ka bashkëpunuar me Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe me institucione të ndryshme në hartimin e standardeve të profesionit dhe kurrikulave në fushën e TIK-ut, si edhe ka marrë pjesë në seminare dhe workshope ndërkombëtare në Zvicër, Austri dhe Hungari.